



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civilë për këtë vend të punës:

Agjencia Gjeologjike e Kosovës - Drejtorati i Gjeoinformacionit dhe Gjeoteknikës
Numri i Konkursit: APF0001968

Vendi i punës: Udhëheqës i Sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeologjisë Inxhinierike-ST/120 / JP00028581

Koeficienti : 8,50

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i Drejtoratit të Gjeoinformacionit dhe Gjeoteknikës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë dhe përfaqëson sektorin e Gjeofizikës me Sizmologji dhe sektorin e Gjeologjisë Inxhinierike
- Udhëheqë procesin e vlerësimeve gjeologo-inxhinierike të trojeve;
- Udhëheqë procesin e shërbimeve gjeologo-inxhinierike;
- Udhëheqë studimet e hollësishme të faktorëve gjeodinamikë që kondicionojnë rreziqet gjeologjike (rrëshqitje, shembje etj.);
- Studime sipas kërkesave emergjente të pushtetit lokal, dhe sipas kërkesave nga palë të treta;
- Udhëheqë projekte e studime për ndërhyrje të shpejtë në mbrojtje të jetës njerëzore, investimeve, veprave të ndryshme etj;
- Kryen punë hulumtuese për projektet komplekse gjeologjike në bashkëpunim me drejtoratet tjera;
- Ofron studime Gjeofizike të emergjencave;
- Drejton punën e rrjetit Seizmologjik të Republikës së Kosovës

- Kryen edhe detyra tjera nga fushëveprimi i sektorit varësisht nga kërkesat e Udhëheqësit të Drejtoratit, si dhe detyrat e përcaktuara me rregulloren e SHGJK-së si dhe legjislacionit në fuqi.

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë universitare
- Përvoja e punës 4 vjeçare në fushën e Gjeologjisë;
- Aftësi menaxheriale dhe udhëheqëse, përkrahja e punës në ekipë, motivimi dhe promovimi i metodave bashkohore të punës;
- Njohje e softwerëve gjeologjik për nevoja të sektorit;
- E preferueshme njohja e gjuhës angleze dhe serbokroate;
- Fleksibil gjatë orarit të punës;
- Aftësi që të punoj në grupe punuese.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PER AVANCIM

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Afati i konkurrimit është prej datës 21 /04/ 2017 deri me date 28 / 04 / 2017, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524.